



QENDRA E STUDENTËVE E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS PRISHTINË	STUDENT'S CENTER OF UNIVERSITY OF PRISHTINA PRISHTINA	STUDENTSKI CENTAR UNIVERSITETA PRISHTINE PRISHTINA
Adresa: Rruga “Agim Ramadani” p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë Tel.: +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976 Web: www.qs.rks-gov.net		

UDHËZUES PËR APLIKIM ONLINE PËR STREHIM NË KONVIKTE

Gusht 2017, Prishtinë

1. Aplikimi i rregullt

Për të aplikuar për strehim në Konvikte ne Qendrën e Studenteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, fillimisht ju duhet të hapni ndonjërin nga shfletuesit (Browseret) e internetit psh. Google Chrome, Internet Expoler, Mozilla Firefox etj. Pastaj shënoni linkun <http://91.187.98.51/qs>

me ç ‘rast ju shfaqet forma e mëposhtme informuese me menyte përkatëse.




Fig. 1 Faqja kryesore e aplikimit online

Shtypim butonin **Apliko tani** ose menynë **Aplikimi** hapet forma për zgjedhjen e Fakultetit ku studioni dhe shënimin e **Numrit personal**.





Fig. 2. Forma për aplikim online për strehim ne konvikte

Këtu duhet ti plotësoni këto të dhëna:

Fakulteti: Zgjidheni nga lista saktësisht Fakultetin në të cilin jeni duke studiuar

Numri personal: Shënoni Numrin personal tuaj (Numrin e letërnjoftimit)

Pas dhënies të sakte të shënimeve të kërkuara shtypim butonin Kërko dhe nëse jeni student i cili i plotësoni kriteret për aplikim do të marrim të dhënat tuaja prej bazës qendrore të SEMS-it dhe do të paraqiten në panel si në fig. 3



The screenshot shows a web interface for the SEMS system. At the top, there is a navigation bar with links for 'Fillimi', 'Kontakti', and 'Aplikimi'. The language is set to 'Shqip | English' and there is a 'Log in' button. The main form area has three input fields: 'Afati' (set to 'Afati i parë pranues'), 'Fakulteti' (set to 'Fakulteti i Shkencave Matematike'), and 'Numri Personal' (with a blue highlight). A 'Kërko' button is to the right. Below this is a blue header 'Aplikuesi për strehim në Konvikt'. The student details are listed: 'Studenti:' (with a blue highlight), 'Statusi: Student i rregullt', 'Fakulteti: Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore', 'Departamenti/Programi: Drejtimi i përgjithshëm', 'Viti aktual i studimeve: 1', and 'Shteti - Komuna: Kosovë - Glogoc'. At the bottom, there is a 'Kategori të Veçanta, Hape' button and a green 'Apliko' button.

Fig. 3. Studenti i gjetur në bazën e shënime SEMS

Nëse studentit aplikon si student pa kategori të veçanta atëherë, studentit nuk do të këtë nevojë të verifikimit të dokumenteve sepse të gjitha të dhënat e nevojshme i marrim prej bazës prej SEMS-it si të dhënat personale, vitin e studimit dhe notën mesatare.

Po ashtu me rastin e aplikimit për strehim në konvikt do të pranoni e-mail për aplikimin që keni bërë, nga ku do të keni linkun për qasjen në Sistemin Online për strehim në konvikte me të dhënat e *përdoruesin* dhe *fjalëkalimin*. E-maili do të ju dërgohet në e-mailin që e keni në bazën e SEMS-it.

Nëse çdo gjë është në rregull me të dhënat e studentit, atëherë në momentin e shtypjes së butonit Apliko shfaqet mesazhi **Të dhënat u ruajtën me sukses.**

Studentët që janë të rregullt jo me kategori të veçanta do të marrin pikë nga nota mesatare dhe nga largësia e komunës së vendbanimit.

2. Aplikimi me kategori të veçantë

Studentët që hyjnë në kategori të veçantë janë:

- Student fëmijë i dëshmorit
- Student fëmijë i prindit invalid i luftës
- Student, prindi i të cilit është veteran i luftës
- Student i të pagjeturit
- Student invalid civil i luftës
- Student i prindit martir i luftës
- Student me aftësi të kufizuara
- Student i të burgosurit, përndjekurit politik
- Student me më shumë se një studentë nga një familje ➤ Student i kategorisë rast social

Për të gjitha këto kategori studenti do të poentohet me pikë veç e veç varësisht se cilës kategori i takon. Pikët janë të caktuar në konkurs për pranim.


Gjatë aplikimit për këtë kategori studenti duhet të zgjedh butonin , me rastin e zgjedhjes të këtij butoni do të hapet forma si në fig. 4.

Fig.

4. Forma për aplikim si student me kategori te veçantë

Për secilën kategori që zgjidheni nga lista ose nga kutitë e më poshtme ju duhet të ngarkoni dokumentin që e dëshmon se ju i përkisni asaj kategorie. Te lista me kategori te veçanta kemi mundësi te zgjedhim këto kategori:

Fig. 5. Lista me kategori te veçanta

Nëse zgjedhim kategorinë e veçantë fëmijë dëshmori duhet të ngarkojmë vendimin ose vërtetimin se studenti në fjalë është fëmijë dëshmori. Shtypim butonin

Ngarko dëshmin këtu 

hapet forma për ngarkim të dokumentit të cilit duhet të kemi ne kompjuterin prej të cilit aplikojmë.




Fig. 6 Ngarkimi i dëshmisë-dokumentit

Pas gjetjes së dokumentit në kompjuterin ose pajisjen ku gjendet dëshmia/dokumenti shtypim butonin **Open** dhe dokumenti ngarkohet në server dhe sistemi na njofton se dokumenti është i ngarkuar me sukses.



Fig. 7. Mesazh informimi për ngarkimin e dokumentit

Nëse gjatë ngarkimit vërejmë se kemi bërë ndonjë gabim shtypim butonin si në Fig. 8 dhe dokumenti fshihet prej serverit dhe kemi mundësi ngarkimi përsëri.



Fig. 8. Fshirja e dokumentit në rast gabimi

Njëta procedurë vepohet edhe me ngarkimin e dokumenteve me kategoritë tjera. **Verifikimin e dokumenteve për kategoritë e veçanta do ta bëjë komisioni me**

anëtar të caktuar nga menaxhmenti i Qendrës Studentore brenda kohës kur aplikimi është i hapur . Të gjithë studentët të cilën kanë zgjedhur një e me shumë kategori të veçante gjatë aplikimit për strehim ne konvikt, duhet të ngarkojnë gjatë aplikimit dokumentet origjinale të skenuara që janë lëshuar nga selitë qendrore të shoqatave të dala nga lufta në Prishtinë dhe institucionet e tjera shtetërore.

3. Aplikimi me index për studentët e mjeksisë viti 5 dhe 6

Studentët të cilët janë në mjeksi në vitin e studimit 6 dhe që nuk kanë përsëritur vite gjatë studimeve kanë mundësi të aplikojnë online për strehim në konvikte. Aplikimi bëhet si në vijim.

- Hapet forma për aplikimi
- Zgjedhni nga lista **Fakulteti i Mjekësisë**
- Te lista **Studentet**, zgjedhni me index
- Plotësoni të gjitha fushat e kërkuara me të dhëna tuaja të sakta.
- Nëse i përkisni ndonjë kategorie të veçantë klikoni butonin kategori e veçantë dhe shfaqet forma për ngarkim të dokumenteve për kategoritë e caktuar, e sqaruar në pikën 2 të këtij udhëzuesi.

Fakulteti Studentet

Fakulteti i Mjekësisë Me Index

Ju lutem plotësoni fushat më poshtë me të dhëna tuaja të sakta, të cilat pastaj do të verifikohen nga Qendra Studentore

Numri Personal	Emri	Emri i prindit	Mbiemri
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Gjinia	Datëlindja	E-mail	Telefoni
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Adresa	Shteti venbanimit	Komuna	Numr index-it
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Departamenti	Viti regjistrimit në Fakultet	Viti i studimeve	Nota mesatare
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>

Duhet te sjellni certifikaten e notave për verifikim

Kategori të Veçanta, Hape

Apliko

Pasi të keni aplikuar duhet të paraqiteni personalisht në Qendrën e Studentëve dhe jeni të sjellni për verifikim këto dokumente: Indexin, letërnjoftimin dhe certifikatën e notave. **Ndryshe aplikimi juaj nuk konsiderohet i vlefshëm!**

Nëse i përkisni ndonjë kategorie të veçantë atëherë vlen e njëjta procedurë për verifikim e sqaruar në pikën 2 të këtij udhëzuesi.

Pasi të keni aplikuar do të njoftoheni me e-mail për aplikimin tuaj.

4. Qasja e studentit në sistemin online për strehim në konvikte

Për tu qasur në sistem, përdoruesi duhet të ketë lidhje interneti, dhe ndonjërin prej shfletuesve të internetit të instaluar në kompjuterin e tij dhe duke klikuar në linkun:

<http://91.187.98.51/qs/Account/Login>




Fig. 9. Forma kryesore për qasje ne sistem

me klikimin e këtij linku do te hapet faqja kryesore ku ne anën e djathtë klikojmë ne menynë **Qasja**, ku me rastin e klikimit do te hapet forma për qasje si ne Fig. 10



10. Qasja në sistem

Fig.

Përdoruesi identifikohet duke i dhënë emrin e Shfrytëzuesit, zakonisht Numri i personal (për student), si dhe fjalëkalimin i cili është numri personal. Nga figura shihet qartë se forma është e thjeshtë dhe për kyçje në sistem duhet që të plotësohen fushat *Shfrytëzuesi* – në këtë fushë shënohet përdoruesi me të cilin dëshirojmë të kyçemi, *Fjalëkalimi* – shënohet fjalëkalimi për përdoruesin përkatës. Pas plotësimit të fushave më lartë shtypim butonin Qasu dhe do të kyçemi në sistem. Varësisht prej rolit të cilit e kemi si përdorues në aplikacion, ashtu edhe janë të mundësuar format nëpër të cilat do të lejohet qasja.

The screenshot shows a web interface for an online application system. At the top left is the QS logo. The top navigation bar includes links for 'Fillimi', 'Kontakti', and 'Historia e aplikimeve'. On the top right, there are language options 'Shqip | English', a user profile icon labeled 'Mirësevini', and a 'Shkyçu' button. The main content area features a large grey box with the heading 'Aplikimi online për strehim në Konvikte për studentet e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"'. Below this heading are two buttons: 'Apliko tani »' and 'Konkursi'. To the right of the main content is a vertical sidebar menu with a blue header 'Faqja kryesore' and several menu items: 'Kriteret', 'Udhëzues per aplikim', 'Dokumentet e nevojshme', 'Kërko rezultatin e pranimit', and 'Faqja zyrtare'. Below the main heading, there is a section titled 'Dokumentet e nevojshme për aplikim dhe nga të cilat mund të fitohen pikë:' followed by a sub-heading 'Dokumentet e nevojshme për aplikim dhe nga të cilat mund të fitohen pikë:' and a button labeled 'Lexo më shumë »'.

Fig. 11. Qasje me llogari te studentit ne sistem